



UDHËZUES

për procedurën e zgjedhjes së Rektorit në Universitetin „Nënë Tereza“ në Shkup

Shkup, 2022



Në bazë të nenit 165 paragrafi 1 alineja 5 të Statutit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Komisioni Universitar Zgjedhor për zgjedhje të Rektorit në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup, në mbledhjen e mbajtur më datën 10.02.2022, miratoi këtë:

UDHËZUES

për procedurën e zgjedhjes së Rektorit
në Universitetin „Nënë Tereza“ në Shkup

A) Puna e Komisionit Universitar Zgjedhor

1. Komisioni Universitar Zgjedhor (në tekstin e mëtejshëm KUZ) punon në mbledhje me përbërje të plotë. Mbledhjet i cakton dhe me të udhëheq Kryetari i KUZ-it, dhe në mungesë të tij një anëtar i autorizuar.
2. Në mbledhjet e KUZ-t marrin pjesë: Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit (pa të drejtë vote), përpiluesi i procesverbalit dhe vëzhguesit e autorizuar.
3. Mbledhjet mund të thirren me shkrim, në mënyrë elektronike ose nëpërmjet telefonit.
4. Kryetari është i obliguar të caktojë mbledhjen e KUZ-it, ashtu siç është përcaktuar me Programin e aktiviteteve për zgjedhjen e Rektorit, si dhe sipas nevojës.
5. Për punën e KUZ-it mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari i KUZ-it dhe përpiluesi i procesverbalit, të cilin e cakton Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit, kryesisht nga radhët e të punësuarve të Shërbimit Qendror Profesional dhe Administrativ të Universitetit. Procesverballi miratohet në mbledhjen e radhës.
6. Për të qenë vendimi i vlefshëm, duhet të jenë të pranishëm të paktën 4 (katër) anëtarë të KUZ-it.
7. Vendimet e KUZ-it miratohen me shumicë votash, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të tij.
8. KUZ ka kutinë e saj postare elektronike. Kutia postare elektronike e përdorin të gjithë anëtarët e KUZ-it.
9. Mbledhjet e KUZ-it mbahen në ambientet e Rektoratit të Universitetit ose online, në varësi të çështjeve të cilat diskutohen në seancë. Të gjitha veprimet administrativo-teknike kryhen nëpërmjet Shërbimit Profesional dhe Administrativ të UNT-së.

B) Puna e Komisioneve Zgjedhore të Njërive

10. Komisionet Zgjedhore të Njërive (në tekstin e mëtejshëm KZNJ) punojnë nëpër mbledhje
11. KZNJ zgjedh nga radhët e anëtarëve të tij zgjedh kryetarin e KZNJ-së. Atë e zëvendëson person i caktuar nga KZNJ.
12. Mbledhjet thirren dhe udhëhiqen nga Kryetari i KZNJ-së.
13. Kryetari është i obliguar t'i caktojë mbledhjet, ashtu siç është përcaktuar me Programin e aktiviteteve për zgjedhjen e Rektorit, ose sipas nevojës.
14. Në Mbledhjet e KZNJ-së, merr pjesë edhe Sekretari (pa të drejtë vote).
15. Për të qenë vendimi i vlefshëm, duhet të jenë të pranishëm të paktën 3 (tre) anëtarë të KZNJ-së/
16. Vendimet e KZNJ-së miratohen me shumicë votash, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të tij.



17. Mbledhjet mund të thirren në mënyrë elektronike ose nëpërmjet telefonit
18. Për punën e KZNJ-së mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari i KZNJ-së dhe përpiluesi i procesverbalit, i cili është Sekretari.
19. Mbledhjet e KZNJ-së mbahen në hapësirat e njësisë (ose në selinë e UNT-së).

C) Materiali zgjedhor

20. KUZ-i paraqet kërkesë deri tek Dekani i njësisë së caktuara dhe deri tek KZNJ-ja i njësive brenda afatit të përcaktuar nga KUZ-i, për ta përgatitur dhe paraqitur listën e anëtarëve të Këshillave Mësimore-Shkencore të njësive. Lista e anëtarëve përfaqëson listën zgjedhore të njësisë (Shtojcë 1:Lista e anëtarëve të KMSH-së). Së bashku me Kërkesën dorëzohet edhe shablloni i listës zgjedhore (Shtojcë 1).
21. Çdo faqe e listës zgjedhore të njësisë nënshkruhet nga kryetari i KZNJ dhe dekani dhe vërtetohet me vulën e njësisë.
22. Lista zgjedhore e njësisë, KZNJ-ja e dorëzon deri tek KUZ-i brenda afatit të përcaktuar me programin e aktiviteteve (Shtojcë 1 e plotësuar). Lista e zgjedhore i dorëzohet KUZ-it në dy kopje origjinale. Në dy kopjet origjinale nënshkruhen nga kryetari i KUZ-it dhe vulosen me vulën e UNT-së. Një kopje i jepet KZNJ-së me materialin tjetër zgjedhor, kurse kopja tjetër origjinale mbetet te KUZ-i. (Shtojca 1 e plotësuar).
23. Në listën zgjedhore të njësisë, anëtarët shënohen sipas radhës së thirrjeve, duke filluar me thirrjen profesor ordinar, profesor inordinar, docent dhe student.
24. Në përputhje me Ligjin për Arsim të Lartë dhe Statutin e Universitetit, Këshilli Mësimor-Shkencor përbëhet nga profesorë ordinar, profesorë inordinar dhe docentët të cilët janë në marrëdhënie pune në fakultet dhe studentët.
25. Listat zgjedhore të njësive, të nënshkruara nga dekani, kryetari i KZNJ-së dhe kryetari i KUZ-it, me vulën e njësisë dhe me vulën e UNT-së, e përbëjnë Listën e Vetme Zgjedhore të UNT-së, (në vijim LVZ). (Shtojca 2: LVZ)
26. KZNJ-ja nga KUZ-i i merr materialet zgjedhore, midis të cilëve edhe materialin konfidencial, i cili është i përgatitur në formë formulari, që është si shtojcë në këtë Ushëzues. Materiali merrret nga hapësirat e Rektoratit në ditën e votimit, nga ora 09:00 deri në orën 10:00. (Shtojcë: Procesverbal për dorëzimin e materialeve).
27. Materiali zgjedhor përbehet nga: lista zgjedhore e njësisë, fletëvotimet, procesverbalet, raportet dhe shenja për vendin e votimit.

Ç) Vëzhgues të autorizuar

28. Secili kandidat për Rektor i dërgon KUZ-it njoftim me shkrim për vëzhguesit e tij personal në KUZ dhe në çdo njësi të KZNJ-së. KUZ-i ia përcjell njoftimin KZNJ-së. Vëzhguesi konfirmon rolin e tij/saj si vëzhgues të autorizuar me vërtetim me shkrim (Shtojcë 4: Vërtetim si vëzhgues i autorizuar) dhe identifikohet me një dokument identifikimi personal.
29. Vëzhguesit kanë të drejtë ta kontrollojnë materialin zgjedhor dhe dokumentacionin tjetër në lidhje me procesin zgjedhor, si dhe të marrin pjesë në votim, në numërimin e votave, si dhe në përcaktimin e rezultateve të votimit dhe dorëzim - pranimin e materialit zgjedhor.



D) Мëныра e votimit dhe numërimi i votave

30. Zgjedhja e Rektorit bëhet me votim të fshehtë, në selinë e Universiteti dhe udhëhiqet nga Komisioni Zgjedhor i Njësisë, në datën e përcaktuar në Planin e aktiviteteve për zgjedhje të Rektorit, në periudhën nga ora 12:00 deri në orën 14:00.
31. Për zbatimin e votimit për zgjedhje të Rektorit, në bazë të listave zgjedhorë të njësisve, KUZ përgatit një listë të veçantë zgjedhore të UNT-së. Votimi i njësisve zbatohet në bazë të Ekstraktit nga Lista zgjedhore të UNT, me fletëvotime të mbrojtura dhe të përgatitur nga KUZ-i. (Shtojca 5: Fletëvotimi).
32. Votimi zhvillohet në një hapësirë të caktuar të njësisë. Në hyrje të hapësirës duhet të ketë njoftim se në të po zhvillohet votimi. Teksti dhe madhësia e njoftimit janë të dhënë bashkangjitur në këtë Udhëzues (Shtojca 6: Informatë për vendvotimin).
33. Komisioni zgjedhor i njësisë rregullon hapësirën e votimit në mënyrë që të gjithë anëtarët e KZNJ-së të ulen në të njëjtin rresht, dhe përballë tyre në një distancë prej të paktën dy metrash në lartësinë rreth 80cm vendoset kutia e votimit. Pas kutisë së votimit në distancë të paktën dy metra nga e njëjta vendoset një paraven, i cili e mundëson fshehtësinë e votimit. Në të majtë ose në të djathtë të kutisë së votimit të vendoset një vend për vëzhguesit e autorizuar dhe të caktuar nga kandidatët për Rektor dhe të autorizuar nga Kryetari i KUZ-it.
34. Vëzhguesi i autorizuar është i detyruar t'i paraqes Kryetarit të KZNJ-së Vërtetim të lëshuar nga Kryetari i KUZ-it, se është përcaktuar si vëzhgues nga njëri prej kandidatëve për Rektor. (Shtojcë 4: Vërtetim se është vëzhgues i autorizuar, i lëshuar nga KUZ-i).
35. Gjatë zbatimit të votimit në hapësirën, përveç anëtarëve të KZNJ-së dhe vëzhguesit e autorizuar, mund të ketë më së shumti dy anëtarë të KMSH-së, të cilët të votojnë (njëri të votojë, tjetri të përgatitet për votim).
36. Votimi zhvillohet në atë mënyrë që anëtari i KMSH-së së pari nënshkruhet në Listën zgjedhore, dhe më pas e merr fletën e votimit të cilën e plotëson pas paravenit dhe e vendos në kutinë e votimit, pas së cilës menjëherë duhet të largohet nga hapësira.
37. Anëtarët e KMSH-së votojnë në këtë mënyrë:
 - votojnë për kandidatët duke rrethuar numrin rendor përpara kandidatit. Votohet vetëm NJË kandidat. Zgjidhet kandidati me më shumë vota.
 - votojnë duke rrethuar NJË OPSION nga oferta PËR ose KUNDËR në rast se në fletëvotimin propozohet vetëm një kandidat. Zgjidhet kandidati me të paktën 51% të votave PËR, në krahasim me votat KUNDËR.

Gjatë votimit të fshehtë, anëtari i Këshillit Mësimor-shkencor të njësisë në fletëvotimin e përcakton kandidatin për të cilin voton duke rrethuar numrin rendor përpara emrit dhe mbiemrit të tij, pra zgjedh njëra nga opsionet PËR ose KUNDËR, në rast kurrë propozohet vetëm një kandidat.

Nëse një anëtar i Këshillit Mësimor-Shkencor i ka rrethuar numrat rendorë përpara emrave dhe mbiemrave të më shumë se një kandidati nga numri i përzgjedhur, pra ka rrethuar të dy opsionet (për dhe kundër), fletëvotimi konsiderohet si i pavlefshëm.

Vletëvotim i paplotësuar, fletëvotimi në të cilin futet emër i ri, ose fletëvotimi nga i cili nuk mund të përcaktohet me siguri se për cilin kandidat ka votuar anëtari i Këshillit Mësimor-Shkencor, atëherë ky fletëvotim konsiderohet si i pavlefshëm.

38. Në orën 14:00 Komisioni Zgjedhor e mbyll vendvotimin dhe kalon në numërimin e votave, vetëm në prani të vëzhguesve të autorizuar. Së pari, konstatohet se sa persona janë të regjistruar në Ekstraktin e Listës zgjedhore, sa kanë votuar dhe sa fletëvotimi kanë mbetur të pashfrytëzuara. Më



pas rishikohen fletëvotimet të përdorura, nëse ka, ndahen ato të pavlefshmet nga fletëvotimet e vlefshme dhe përcaktohet numri i tyre.

39. Pastaj, nga numri i votave të vlefshme përcaktohet numri i votave që ka fituar secili prej kandidatëve.

E) Përcaktimi i rezultateve të votimit

40. Në bazë të numrit të votave të fituara, përcaktohet edhe numri i pikëve të fituara për secilin kandidat. Numri i votave të fituara nga secili kandidat në çdo njësi shprehet në mënyrë të veçantë në përqindje të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të njësisë dhe shumëzohet me numrin e senatorëve të zgjedhur nga njësia, që jep numrin e pikëve të fituara nga secili prej kandidatëve.

Llogaritja bëhet sipas formulës së më poshtme:

(Numri i votave të fituara nga secili kandidat në njësi / numri i votave të vlefshme në njësi x 100)% x numri i senatorëve të zgjedhur nga njësia = numri i pikëve të fituara nga ana e kandidatit.

Shembull:

$$(16/31 \times 100)\% \times 2 \text{ senatorë} = 103,226 \text{ pikë}$$

Në rast votimit të vetëm një kandidati, krahasohen pikët për secilin opion (Për ose Kundër), përkatësisht llogaritet se sa pikë merr secila nga dy opsionet, sipas të njëjtës formulë (numri i votave të fituara shprehet në mënyrë të veçantë me përqindje të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të njësisë dhe shumëzohet me numrin e senatorëve të zgjedhur nga njësia, me çka fitohet numri i pikëve të fituara të kandidatit; e njëjta gjë përsëritet për opsionin kundër). Në fund, llogaritet përqindja e krahasuar e votave Për dhe Kundër në nivel të njësisë.

Rezultati i dhënë në pikë të cilët i kanë fituar kandidatët, rrethohet në tre decimale, kështu që nëse shifra e parë e numrave që mungojnë është 0,1,2,3 ose 4, atëherë shifra para saj nuk ndryshon dhe nëse shifra e parë të numrave që mungojnë është 5, 6, 7, 8 ose 9, atëherë shifra para saj rritet për 1.

Shembull:

$$5,164398 \text{ rrumbullakoset në } 5,164$$

$$5,164518 \text{ rrumbullakoset në } 5,165$$

41. Shqyrtimi i numrit të senatorëve të zgjedhur sipas njësive është pjesë përbërëse të formularëve ndaj Udhëzuesit (Shtojca 7: Shqyrtimi i numrit të senatorëve të zgjedhur sipas njësive).
42. Pasi të vërtetohen rezultatet e votimeve, Komisioni Zgjedhor i Njësive, e plotëson Raportin (Shtojca 8: Raport për votimet e kryera të Njësive) dhe të njëjtin së bashku me Procesverbalin e votimit të zhvilluar dhe materialin tjetër zgjedhor, i dorëzon te KUZ-i, në përputhje me Planin e aktiviteteve për zgjedhje të Rektorit (Shtojca 9: Procesverbal për kryerjen e votimit dhe materialin tjetër të KZNJ deri te KUZ).
43. Pas fitimit të rezultateve të votimit të kryer nëpër njësitë e KZNJ-së, KUZ-i bën kontrollimin e tyre, i sumon rezultatet e votimit nga të gjithë njësitë e Universitetit me Procesverbal (Shtojca 10: Procesverbal i KUZ për sumimin e rezultateve) dhe sjell Vendim për zgjedhjen e Rektorit të Universitetit. (Shtojca 11: Vendim për zgjedhje të rektorit). Kandidati me numër më të madh të pikëve zgjidhet Rektor i Universitetit. Në rast se votohet për një kandidat, sumohen rezultatet e



votave Për dhe Kundër të të gjitha njësive dhe llogaritet përqindja krahasuese të votave Pro dhe Kundër në nivel Universiteti. Nëse për kandidatin e vetëm kanë votuar Për më shumë se 51% të votave të vlefshme, kandidati konsiderohet i zgjedhur për Rektor të Universitetit. Në rast se rezultati i votimit, pra pikët janë të barabarta ndërmjet kandidatëve, KUZ do t'i përsëris zgjedhjet midis dy kandidatëve që kanë numër të njëjtë të pikave.

44. Rezultatet do të publikohen në ueb-faqen e Universitetit

F) Mënyra e komunikimit dhe dorëzimi i dokumentacionit, akteve, njoftimeve, procesverbaleve etj.

45. Kandidatët për rektor paraqitjen së bashku me dokumentacionin e dorëzojnë në përputhje me shpalljen e Senatit.

46. Komunikimi midis anëtarëve të KUZ-it dhe KZNJ-së, zhvillohet nëpërmjet kutive postare/adresave elektronike të KUZ-it dhe KZNJ-së. KZNJ-ja i dorëzon adresat elektronike deri tek KUZ. KUZ-i e poston adresën e tij elektronike në faqen e internetit të Universitetit. Komunikimi mund të bëhet edhe nëpërmjet telefonit. Të dy mënyrat konsiderohen si komunikim i rregullt.

47. Dorëzimi i dokumentacionit etj. (nëse është e nevojshme), përveç materialit zgjedhor, ndërmjet KUZ dhe KZNJ zhvillohet në mënyrë elektronike.

48. Komunikimi ndërmjet KUZ-it dhe njësive, gjithashtu zhvillohet në mënyrë elektronike. Kutia postare elektronike e njësisë është kutia postare e regjistruar në gjendjen aktuale të Universitetit, për çdo njësi veç e veç. Komunikimi mund të zhvillohet edhe nëpërmjet telefonit. Të dyja mënyrat konsiderohen si komunikim i rregullt.

49. Komunikimi ndërmjet anëtarëve të KUZ-it dhe kandidatëve për rektor zhvillohet në mënyrë elektronike në kutitë postare elektronike të kandidatëve, të dorëzuara në paraqitjen për rektor dhe kutinë postare elektronike të KUZ/KZNJ dhe nëpërmjet telefonit. Të dyja mënyrat konsiderohen si komunikim i rregullt.

50. Dorëzimi i parashtresave, akteve dhe dokumentacioneve të tjera ndërmjet KUZ dhe kandidatëve për rektor bëhet në mënyrë elektronike në përputhje me pikën 48 në bazë të pëlqimit të kandidatit(ëve) (Shtojca 12 Pëlqim). Dokumentacioni duhet të nënshkruhet dhe skanohet ose nënshkruhet me nënshkrim elektronik nga një person/persona i/të autorizuar. KUZ-i dhe kandidatët për rektor njoftohen nëpërmjet telefonit se dokumenti përkatës është dërguar nëpërmjet postës elektronike.

51. Pranimi, dorëzimi dhe etj. të dokumentacionit zgjedhor (procesverbali, raporti, fletëvotimet etj.) bëhet drejtpërdrejt nga ana e KUZ-it deri tek KZNJ dhe anasjelltas, në Rektoratin e UNT-së.

52. Gjatë dorëzimit elektronik të dokumenteve, momenti i dorëzimit/pranimit të dokumentit konsiderohet momenti kurrë është dorëzuar njoftimi me shkrim.

G) Ruajtja dhe mbyqirja e dokumentacionit zgjedhor

53. Dokumentacioni zgjedhor në lidhje me procedurën zgjedhore për Rektor mbahet nga Shërbimi Qendror Profesional dhe Administrativ të Universitetit.

54. Kontrollimi i dokumentacionit zgjedhor mund t'u lejohet personave dhe organeve që do të vërtetojnë interes të justifikuar për të.



55. Deri në përfundimin e procedurës për zgjedhjen e Rektorit, për ekzistimin e arsyeshmërisë e kontrollimit të dokumentacionit vendos KUZ-i, kurse pas mbarimit të procedurës, organi gjegjësisht trupi ose person të cilin do ta emërtojnë Sekretari Gjeneral i Univrsitetit.

H) Çështje të tjera që lidhen me procedurën e votimit dhe përcaktimin e rezultateve të votimit.

56. Për realizimin praktik të votimit, KUZ-i përgatiti një Aneks, i cili është pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi, me formularë të unifikuar që do të vlejnjë për të gjitha njësitë (procesverbale, raporte, njoftime, vërtetime, postera, etj.).

**Kryetari i Komisionit Zgjedhor të Universitetit
Prof. dr. Mustafa Ibrahim i d.v.**